



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 11 maj 2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Kosara Nikoliq, Riza Smaka, Synavere Rysha, Enis Kervan, Anita Morina- Saraçi dhe Naser Osmani.

Mungoi: Gani Koci

Nga ZAP mori pjesë: Lars Lage Olofsson – Auditor i Përgjithshëm,

Të pranishëm: nga KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi, Shpresa Miftari - praktikante, Qëndresa Mulaj - ZAP, OSBE - Lejla Selimi, KDI – Jusuf Zejna dhe nga Zyra e Presidentit Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi Haki Shatri, kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Shqyrtimi i raportit për funksionimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009,**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor të performancës për vitin 2009 – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm,**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – Theksoi se në rendin e ditës nuk është përfshirë procesverbali nga mbledhja e kaluar për shkak të kohës së shkurtër dhe ai është në procedura të përkthimit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit për funksionimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës për vitin 2009

Kryesuesi konstatoi se në mungesë të përfaqësuesve nga Ministria e Financave, përkatësisht përfaqësuesve nga Njësia Qendrore për Harmonizim, kjo pikë e rendit të ditës, shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Komisionit.

3. Shqyrtimin e raportit vjetor të performancës për vitin 2009 – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Kryesuesi – Ftoi z.Lars Lage Olofsson – Auditor i Përgjithshëm, që të prezantojë raportin që është pikë shqyrtimi.

Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm – Tha është përgjegjës për mënyrën se si është shpenzuar buxheti. Është një praktikë e mirë që të gjithë shpenzuesit buxhetor të përgatisin një raport të tillë. ZAP është duke e finalizuar sezonin e auditimit në muajin gusht, do të fillojmë me sezonë të re në muajin shtator. Ai shtoi se ky raport e mbulon sezonin e auditimit për vitin 2008 dhe 2009 si dhe fazën e parë të auditimit 2009 – 2010. Çështja është se si janë shpenzuar burimet buxhetore të këtij viti. Aktualisht ZAP është duke kryer shumë më shumë auditime se më parë. Këtë vit do të kryhen rreth 74 auditime, në krahasim me 25 që janë bërë në sezonin e kaluar. Të gjitha këto auditime do të realizohen me kohë, para fundit të muajit qershor. ZAP ka paraqitur atë që quhet auditim i përkohshëm, ku kanë pasur mundësinë të komunikojnë me të gjitha entitetet e audituara gjatë vitit fiskal. Për sa i përket reformës në administratën publike, ku është planifikimi për Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, ZAP ka filluar me një projekt binjakëzimi me kolegët nga Britania e Madhe, Sllovenia dhe Holanda. Kanë përdorur edhe partnerë privatë sa i përket auditimit të komunave. Buxheti është ekzekutuar në një mënyrë më të mirë se sa që është bërë përpara, edhe pse nuk kanë pasur fonde dhe kohë të mjaftueshme për të bërë atë që është dashur të bëhet. Sa i përket rritjes së numrit të stafit në këtë institucion, tani janë 126 persona, në krahasim me vitin e kaluar ku kanë qenë 96, prej tyre 46 janë femra, në krahasim me vitin e kaluar që kanë qenë 28. Në krahasim me vitin e kaluar janë forcuar marrëdhëniet ndërkombëtare dhe kanë pasur mundësinë që të bëjnë më shumë veprim për sa i përket raporteve. Pasqyra e të ardhurave e paraqitur në këtë raport nuk është e audituar dhe kjo është një mangësi e cila do të adresohet nga Komisioni Evropian. Sfidë për ZAP është edhe akomodimi në një ndërtesë të re. Sipas auditorit të përgjithshëm, paratë që janë investuar në ZAP, janë përdorur mirë, dhe të gjitha investimet që do të bëhen në këtë institucion do të përdoren mirë.

Naser Osmani – Pyeti: A është i kënaqur Auditori i përgjithshëm me stafin që ka? A keni bërë ndonjë herë auditim për ndërmarrjet që marrin mjete të konsiderueshme nga Buxheti i Kosovës? p.sh KEK-u (hiq më pak se 500 milion). Në bazë të raporteve të KRPP, KEK-u të gjithë tenderët i ka një burimor. ZAP ka për obligim të auditoi të gjitha mjetet e Buxhetit të Kosovës. Kur mundet Komisioni të marr informacione për mjetet që janë marrë nga Buxheti i Kosovës?

Synavere Rysha – Pyeti: cila është arsyeja që ZAP ka angazhuar kompani private për auditimin e komunave? Ajo tha se ZAP ka audituar ministritë dhe institucione të tjera, por është shqetësues fakti që shumë pak është prekur Agjensioni Kosovar i Privatizimit, PTK dhe Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Kërkoi koment nga Auditori i Përgjithshëm për këto tri çështje.

Safete Hadergjonaj – Tha se performanca e punës së Auditorit Gjeneral është shumë më pozitive. Ne faqen 4 të raportit thuhet “...ne nuk jemi te detyruar të bëjmë raporte të performancës...”, dhe ZAP ka bërë dy raporte të tilla. Pyeti: Si i bënë ZAP këto raporte, merr vet iniciativa apo kërkon nga të tjerët? Sipas raportit një Komunë ka refuzuar të prodhojë Planin Vjetor të Pasqyrave Financiare dhe si pasojë e kësaj, ZAP nuk ka mundur të kryej auditimin. Pyeti: Cila është kjo Komunë? Gjatë punës ZAP ka pasur ndihma nga jashtë, 697,315 euro si donacion. Janë shpenzuar 118 mijë euro për shërbime intelektuale dhe këshillëdhënëse, kërkoi

sqarim se për çka është fjala? Kërkoj sqarim se pse nuk është bërë auditimi i disa ndërmarrjeve më të rëndësishme? A ka pas ZAP ndonjëherë auditor të brendshëm apo kjo është bërë vetëm tani?

Riza Smaka – Pyeti: pse të angazhohen kompani private për auditim, përderisa ZAP i ka të gjitha komponentet e performancës për ta ushtruar detyrën në mënyrë efikase e eficiente? Për të është shumë shqetësuese çështja e tenderëve. Është bërë praktikë e rregullt, që për çfarëdo transaksioni është *“sekret publik se duhet të jep 20% i kontraktuari eventual”*. Ishte i mendimit se çështje kryesore me të cilën do të duhej të merrej auditori është Ligji për Auditim i cili ka shumë defekte. Sipas Raportit ZAP ka për mision që *“të kontribuojmë për një menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike”*, por nuk duhet ndalur vetëm në administratë publike pasi që edhe në Ndërmarrjet Publike paratë publike shpenzohen pa kriterë, pagat jepen pa kriteriume etj. Sipas raportit, ka një rritje të shpenzimeve - pagat dhe mëditjet, madje në buxhetin e rishikuar për vitin 2009 tejkalon 666. Pyeti: çfarë janë *“shërbimet e ndryshme intelektuale këshillëdhënëse”*, a thua ZAP nuk ka staf profesional e intelektual? Stafi i ZAP-it janë të paguar mirë, janë të trajtuar si intelektual dhe profesionalist, por nëse duhen staf i jashtëm, atëherë del se stafi i ZAP-it nuk është profesional dhe intelektual, kjo është shumë kontradiktore. Dyshon që këtu dikush po favorizohet pa bazë, pa moralitet. Po ashtu pjesa që ka të bëjë me furnizime për zyrë për vitin 2009, është një rritje shumë e madhe, krahasuar me vitet paraprake. Furnizime për veshmbathje, pyeti: ku jepen këto para, për çfarë veshmbathje është fjala? A ka bazë ligjore një gjë e tillë? Qiraja për ndërtesë 168 mijë euro, është marramendëse.

Enis Kervan – Kërkoj sqarim lidhur me atë që ZAP ka kërkuar fonde shtesë për staf shtesë. Ai tha se realizimi i buxhetit për pagat dhe mëditjet nuk është i mirë aq sa do të duhej të ishte, por sipas tabelës në buxhetin e përgjithshëm ka një ulje, ndërsa në pjesën paga dhe mëditje ka një ngritje, kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Kosara Nikoliq – Tha, sipas raportit janë audituar 32 komuna, përveç Komunës së Prishtinës për vitin 2008, për të cilat janë angazhuar kompani private të auditimit. Pyeti: a nuk ka pasur ZAP pushtet për të kryer auditimin e Komunës së Prishtinës për vitin 2008? Kjo duke pasur parasysh që në këtë Komunë punohet me buxhetin më të madh.

Kryesuesi - Pyeti: raporti vjetor i auditimit që do të procedohet për vitin 2009, a do të përfshij edhe performancën e organizatave buxhetore apo vetëm pasqyrat financiare? Si ndodhi që në raportin e vitit të kaluar vlerësimi për disa organizata buxhetore ka qenë i pakualifikuar (që në gjuhën e thjeshtë do të thotë “vlerësim i mirë”), në ndërkohë ka dilema rreth keqpërdorimeve në ato organizata buxhetore? Pse nuk janë audituar ndërmarrjet më të mëdha publike që kanë edhe probleme më të mëdha? Mos akomodimi i ZAP në objekt, a ka ndikuar edhe në performancën e ZAP-it?

Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm – Tha, Kuvendi ka aprovuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike, sipas të cilit auditimi në ndërmarrjet publike bëhet nga firma private i cili do të përzgjedhjet nga vet ky entitet. Niveli profesional nuk është në nivelin e dëshiruar, por ZAP është në një proces të ngritjes së kapaciteteve. ZAP ka filluar për të bërë auditimin e Fondit të Privatizimit, RTK-në etj. Do të analizoj se cilat do të jenë institucionet që do t'i auditoj gjatë vitit të ardhshëm. Në këtë pikë KMFP, mund ta ndihmoi ZAP-in duke dhënë ide.

Përdorimi i auditorëve privatë, është bërë për dy arsye; Numri i auditorëve në ZAP gjatë viteve 2008, 2009 ishte 54, ata ishin në grevë për dy muaj (në atë kohë) dhe menaxhmenti në atë kohë kishte burime për të gjetur alternativa, por nuk e ka bërë një gjë të tillë, tani me ndërtimin e institucionit ton numri i auditorëve është 86, 35 janë të rinj, janë trajnuar në të njëjtën kohë që kryhen auditimet. Auditimin e komunave më të mëdha e bëjmë vet, kemi audituar Prishtinën vitin e kaluar, këtë vit Prizrenin dhe dy ose tre komuna të tjera, si dhe Komunën e Leposaviqit e cila është komuna që nuk ka përgatitur pasqyrat financiare. Ne nuk blejmë veshmbathje, është një formë standarde e Qeverisë të cilin ata e përcaktojnë për shpenzime, këto janë shërbime teknike, kur flitet për veshmbathje nuk është fjala për veshmbathje. Pajtohem me mendimin se

mos akomodimi i ZAP, ka ndikuar në performancën e tij. Kam punuar për këtë çështje për më shumë se një vit, kam kërkuar të kem edhe ndihmën e Parlamentit, jemi aty ku jemi, nuk kam buxhetin për koston të cilën kam. Sfidë më e madhe është që unë po përdor parat për të paguar qiranë dhe atë 17 – 18 mijë euro në muaj. Kur Kuvendi vendosi për buxhetin e ZAP, situata ishte që ZAP duhej të vendosej në institucionet publike, kjo nuk ka ndodhur.

Naser Osmani – Tha, siç po duket ZAP edhe për vitin e ardhshëm do të kërkoj mjete për qira. ZAP është themeluar nga Kuvendi, andaj nuk mund të pres nga Qeveria. Pyeti: pse nuk keni kërkuar lokacion nga Komuna, pastaj për të kërkuar nga Kuvendi mjete për ndërtimin e një objekti? A mund të kryhet kjo për këtë vit? Kjo, sepse KBF është i gatshëm t'ju ndihmoi në këtë drejtim, por Komisioni nuk mund të bëjë punën që ju jeni të detyruar ta bëni. Megjithatë kjo çështje do të diskutohet në KBF.

Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm – Këtë çështje e kam ngritur në KBF në janar, i cili do të merrte vendim, do t'ja kthente ministrit të financave dhe të administratës publike. Ne kemi pasur mundësinë që të diskutonim për të ndërtuar një ndërtesë të re, por nuk është një çështje që zgjidh problemin aktual, sepse për këtë do të nevojiteshin 2 – 3 vjet.

Stafi nuk është i mjaftueshëm, Kosova ka nënshkruar një marrëveshje me Bashkimin Evropian, stafi në zyrën time do të shkojë nga 60 në 120 në vitet në vijim, vjen duke u zvogëluar numri i ndërkombëtarëve që punojnë në ZAP. Për vitin 2009, në fillim të vitit ne kemi pasur 19 persona, ne fund të vitit 106, këtu ka një diferencë prej 16. Për këtë nuk kam marrë mjete të mjaftueshme nga Kuvendi deri në nëntor, u dashtë t'i punësoja në fillim të vitit dhe kjo qon te ajo që kam shpenzuar 80% të buxhetit për stafin. Është sistemi i marrjes së njerëzve të rinj në ZAP, për herë të parë në këtë organizatë emërohet një auditor i brendshëm, fondi për këtë përfshihet brenda shumës 80%.

Kemi filluar auditimin e RTK-së në shtator dhe do të prodhojmë një raport, por kjo nuk do të ketë lidhje me pasqyrat financiare, por me menaxhimin e organizatës. Ne fund të gushtit do të merrni një raport përfundimtar të auditimit i cili do të bazohet në 72 -73 auditime të pasqyrave financiare dhe disa auditime të performancës.

Kryesuesi konstatoi se KMFP njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. *Të miratohet raporti vjetor i performancës për vitin 2009 i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm;*
2. *Të kërkoj nga Qeveria të inicioj procedurën për ndryshimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike, në pjesën që ka të bëjë me auditimin.*
3. *Të ofrohet përkrahje institucionale për akomodimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*

4. Të ndryshme

Kryesuesi –Njoftoi anëtarët e Komisionit se çështja që është ngritur në KMFP, lidhur me auditimin e RTK-së, ka marrë informatë nga auditori se - auditimi është kryer me kohë dhe se raporti i është dorëzuar me kohë kryetarit të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Haki Shatri